



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e dates 4 qershor 2008, nenit 18 dhe 20 të Ligjit nr. 06/l-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 10 e datës 03 prill 2019, Rregullores (QRK) nr. 09 /2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës si dhe nenit 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i dates 24.12.2021 , Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me 25.11.2022, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës mori këtë:

VENDIM PËR ZËVENDËSIMIN E ANËTARIT TË KOMISIONIT TË ANKESAVE

Neni 1

Me këtë Vendim **zëvendësohet** anëtari i Komisionit të ankesave për shqyrtimin e ankesave të palëve në procedurën e dhënies në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës së Lipjanit, Ferdian Shala në numrin rendor 5, i emëruar sipas Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr.15-020/04-11341 të datës 28.02.2022 për formimin e komisionit të ankesave sipas kërkesës së tij për dorëheqje dhe në vend të tij caktohet Erëblina Salihu poashtu nga sektori joqeveritar lokal- OJQ YAHR.

Neni 2

Detyrat, përgjegjësitë, mandati dhe kompensimi i anëtarëve të komisionit është i përcaktuar me dispozitat e Vendimit të Kuvendit të Komunës për formimin e komisionit të ankesave Nr.15-020/04-11341 të datës 28.02.2022.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në WebFaqen e Komunës.

15Nr. 020/04-63548

Lipjan, më 25.11.2022

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

Kryesuesi i Kuvendit
Daut Azemi

